



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Klllokot-Vrbovcë**

---

Në bazë të rregullores neni 17 (b,s)Ligji nr.03/ L- 040 mbi Vetëqeverisjen Lokale si dhe Statutit të komunës Klllokot-Vërbovc nga neni 8.(b,s),Kuvendi komunal në seancën e tretë të rregullt të mbajtur më datë: 31.03.2011,aprovoi:

**RREGULLORËN 03/2011**  
**MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË KORRJEVE DHE SHIRJET**

**Neni 1**

- 1.1 Duke filluar nga gjendja momentale se korrja dhe shirjet e grurit dhe dritherave të tjera bëhet në një periudhë të shkurtër dhe organizimi I punëve duhet jetë në gjendjen e kërkuar.
- 1.2 Vonesa e mbjelljeve 5-10 ditë rendimentet zvogëlohen prej 4-10%.
- 1.3 Korrjet dhe shirjet duhet të bëhen pastaj, kur të vërtetohet se kultura e përmendur gjinden në fazën e pjekurisë.
- 1.4 Në nivelin komunal caktohet komisioni për korrje-shirjet e cila në të njejtën kohë kryen edhe kontrollimin teknik të makinerisë për korrje shirjet.

**Neni 2**

Cmimi i korrjeve përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë, ndërsa zbatimin e saj e kryen sektori i bujqësisë, Depratmenti për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, e cila do të jetë \_\_\_\_\_ € duaj të palidhur dhe \_\_\_\_\_ € duaj e lidhur për 1 hektar.

**Neni 3**

- 3.1 Autokomajat duhet ti përmbahen rregullave të korrjeve dhe shirjet sic janë:
  - a) që korrjen dhe shirjet ta kryejnë në afatin kohor dhe me kualitet e cila obligon që korrja dhe shirjet të bëhen në afatin e parapë kohor dhe me kualitet e cila siguron që humbja e sasisë së grurit të mos jetë më e madhe se 3 %

- b) lartësia e korrjeve ( serrnishta) të mos jetë më e madhe se 15 cm
  - c) të respektohen cmimet e vendosura për kryerjen e korrjeve dhe shirjet;
  - d) që me kohë të kryhen pregaditjet teknike dhe pregaditjet tjera për kryerjen e dhe korrjeve.
- 3.2 Autokombajnerët duhet të trajtojnë të gjithë bujqit në mënyrë korrekte, pa kurrfarë dallimi, të mbajnë evidencë të saktë për korrje-shirjet, në autokombaja të jetë e qartë shenja kundër zjarrit, e cila duhet rrespektuar nga të gjitha palët, të kenë aparatet kundër zjarrit dhe mjetet tjera ndihmëse.

#### **Neni 4**

Prodhuesit bujqësor janë të obliguar që:

- a) me kohë të pregadisnin parcelat që pa pengesë ti kryejnë korrjet dhe shirjet ( pastrimin e vrazhdë të korës ,eliminimin e të gjitha barnishtave dhe pengesave tjera)
- b) të sigurojnë rrugën për kalim parcelave ( mbylljen e kanaleve dhe rrafshimin e terrenit).

#### **Neni 5**

Për kushtet e korrjeve dhe shirjet autokombajnerët dhe bujqit duhet me kohë të informohen.

#### **Neni 6**

Organi përgjegjës i drejtorisë nga neni 1 i kësaj Rregullore autorizohet që:

- a) kontrollojë rrespektimin afateve të caktuara për kryerjen e korrjeve dhe shirjet me kohë gjendjen teknike të pajisjeve për korrje dhe shirjet, rradhitjen e korrjeve-shirjet ,rregullisht ti ketë instrumentet për matje , mbrojtjen në punë mjetet mbrojtëse kundër zjarrin dhe të ngjajshme,
- b) ti ndaloj punën makinerisë( autokombajës), për kryerjen e korrjeve dhe shirjet në rastet e gjendjes jot ë mirë teknike ose humbjën e drithërave deri në 3 %

#### **Neni 7**

Masat ndëshkuese në shumë prej 100 deri 200 € ,dënohet pronari i makinerisë për kryerjen e korrjeve dhe shirjet, nëse punon në kundërshtim me udhezimet e nenit 3 .të kësaj RRegullore.

## Neni 8

Për zbatimit e kësaj Rregullore do të përkujdeset drejtori I drejtorisë , palët përgjegjëse për tokën bujqësore nga sektori I bujqësisë.

## Neni 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e aprovimit në Kuvend ,gjithashtu do të publikohet në tabelën e shpalljeve të komunës për mjetet informuese dhe qytetarët.

**KUVENDI KOMUNAL  
KLLOKOT-VËRBOVC  
KRYESUESI I KUVENDIT**

nr. 03/2011  
Datë: 31.03.2011

  
/ Žarko Dejanović /

